



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .04.2021

**MBLEDHJA Nr. 19,**  
**datë 06.04.2021, ora 09:30**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 06.04.2021, ora 09:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 19 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)
3. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 35, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar, për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike BPGE 1 dhe BPGE 2”
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k, për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë Gerti sh.p.k për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s, për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hecet: “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kW, Hec “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, Hec “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW, Hec “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500

kW, Hec “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total të instaluar 7320 kW

7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës nr. 461/1 seria P20, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2020, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hecet: “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kW, Hec “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, Hec “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW, Hec “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500 kW, Hec “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total të instaluar 7320 kW

## 8. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike. Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**